



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 85

Prishtinë, më 17.07.2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinkovic, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Ganimete Musliu, Vjollca Krasniqi, Rasim Demiri.

Mungoi: Danush Ademi

Pjesëmarrës nga Institucionet e tjera: Fahredin Verbovci, Policia e Kosovës, Hamndi Hyseni, Policia e Kosovës, Fahri Maxhuni, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Abdyl Limani, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Arber Gorani- ICITAP, Drita Perezic- ICITAP, Visar Rushiti- GAP, Skender Perteshi- QKSS, Faton Hamiti- EULEX, Johanesh Keulens- EULEX, Sanije Berisha-OSCE, Dhurata Kryeziu- OSCE

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

Dëgjim publik për mbikëqyrjen e shpenzimeve financiare të institucioneve të sigurisë.

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.*

Kryetari i Komisionit- Hapi takimin e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me pikën e rendit të ditës, dëgjim publik për mbikëqyrjen e shpenzimeve financiare të institucioneve të sigurisë, me theks të veçantë të Ministrisë së punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës

Fillimisht theksoi se Komisioni në kuadër të funksionit që ka të mbikëqyr Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka formuar grupin punues që të mbikëqyr shpenzimet financiare nga ana e ministrisë, në mënyrë që performanca e tyre të jetë e përgjegjshme.

Grupi punues i kryesuar nga z. Fatmir Xhelili, ka shqyrtuar lëndët, nga të cilat është parë nëse është respektuar baza ligjore për realizimin e tyre. Fjalën ia kaloi z. Fatmir Xhelili.

Fatmir Xhelili- Njoftoi se Komisioni për Punë të Brendshme, ka formuar grupin punues i cili do të merrej me mbikëqyrjen financiare të segmenteve të sektorit të sigurisë. Qëllimi i këtij procesi ka qenë të shikohet kualiteti i mënyrës së menaxhimit të financave nga sektori i sigurisë.

Grupi punues është përcaktuar që të bëjë mbikëqyrjen financiare për Policinë e Kosovës dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Marrë parasysh që grupi punues nuk ka pasur përvojë në këtë fushë, janë konsultuar zyrtarë të kësaj fushe, përfaqësues nga OSBE-ja. Ndihmë është kërkuar nga ana e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, të culet i falënderoj për bashkëpunimin, gjithashtu ndihmë është kërkuar edhe nga ana e Auditorit të Përgjithshëm, i cili fillimisht i është përgjigjur ftesës, ndërsa tutje nuk është ofruar ndihma nga ana e tij gjatë procesit dhe për këtë kam vërejtje, pasi është instrument i Kuvendi të Kosovës dhe Komisioni ka të kërkoj ndihmën nga ky institucion.

Grupi punues gjatë procesit të mbikëqyrjes, ka kërkuar nga Policia e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme, dokumentacionin për mallra dhe shërbime për tre vitet e fundit, 2010, 2011 dhe 2012, kopje të kontratave të konsulencës dhe të dokumentacionit tenderues në vlerë të barabartë ose mbi 10 mijë euro, për vitin 2010, 2011 dhe 2012. Gjithashtu janë kërkuar kopja e të gjitha kontratave të prokurimit në vlerë të barabartë ose mbi 10 mijë euro, kopje që lidhen me shitjen e aseteve në vlerë të barabartë ose më shumë se tre mijë euro për vitin 2010, 2011 dhe 2012.

Është bërë përzgjedhja e rastësishme e lëndëve dhe janë analizuar në detaje, për të parë se sa zyrtarët e prokurimit i përmbahen Ligjit për buxhet dhe Ligjit për menaxhimin e financave publike, përmbajtjes së procedurave, përgatitjen e stafit dhe nëse lëshimet eventuale janë apo jo të qëllimshme.

Tutje falënderoi zyrtarët e KRPP-së, të cilët kanë ofruar ndihmën në analizimin e disa lëndëve, për të cilat pas analizës është konstatuar se ka lëshime esenciale.

Vjollca Krasniqi- Gjatë procesit të mbikëqyrjes së shpenzimeve buxhetore për institucionet e sigurisë, bashkëpunimi ka qenë i mirë me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, mbështetja nga OSBE-ja. Gjatë procesit të mbikëqyrjes krahas

mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për prokurimin publik dhe shpenzimit të parasë publike, është bërë analiza e lëndëve ku kanë dalë të gjetura.

Grupi punues edhe pse nuk ka pasur përvojë në këtë drejtim, ka arritur që të identifikojë lëshime që janë bërë gjatë zbatimit të Ligjit për prokurim publik dhe ligjit për menaxhimin e financave publike.

Rexhep Selimi- Konsideroi se grupi punues ka bërë punë të mirë gjatë mbikëqyrjes së buxhetit të institucioneve të sigurisë, gjithashtu është ofruar bashkëpunim nga ana e institucioneve relevante gjatë kësaj mbikëqyrje. Gjatë këtij procesi, grupi punues ka identifikuar të gjetura të cilat nuk janë të kënaqshme.

Pyetjet e mia i referohen përgjegjësisë politike, dhe për këtë do të jem i mangët pasi në takim nuk janë përfaqësuesit që kanë përgjegjësi politike në marrjen e vendimeve të caktuara në institucionet që kemi mbikëqyrur, siç është Ministria e Punëve të Brendshme.

Kryetari i Komisionit- Njoftoi se mos prezenca e Ministrit të MPB-së, është arsyetuar pasi ka qenë prezent në dëgjimin i cili është organizuar nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, por një arsyetim i tillë nuk e arsyeton mos prezencën e tij, pasi secili komision ka nën përgjegjësi të mbikëqyrë ministritë e linjës.

Ramiz Lladrovci, nënkryetar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike- Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, para dy ditësh ka shqyrtuar raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për MPB-në dhe PK-në.

Për vitin 2011 dhe 2012, opinioni për MPB-në, bazuar në këtë raport është i mirë për këto dy vite. Gjithashtu gjatë dëgjimit publik i është kërkuar Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, që të ndaj auditivin e Ministrisë së Punëve të Brendshme nga Policia e Kosovës, pasi për PK-në ka pasur më shumë të gjetura në raportin e 2012, siç është rasti me blerjen e municioneve dhe gazeve, për të cilat procedurat janë të veçanta, gjithashtu janë bërë vërejtje edhe për Flotën e Policisë.

Fatmir Xhelili- Do duhej të përmendet relacioni mes institucioneve që janë shfrytëzuese të buxhetit me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik dhe Organin Shqyrtues të Prokurimit. Mos koordinimi i aktiviteteve mes këtyre institucioneve në zbatimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike, Ligjin për prokurimin publik.

Në Policinë e Kosovës, gjatë proceset të mbikëqyrjes është vërejtur që janë bërë lëshime në procedura, si dhe mangësi në aspektin e përcjelljes së implementimit të projekteve. Gjithashtu nga ana e tyre nuk janë bërë konsultime paraprake me KRPP-në për mënyrën e shpalljes së tenderëve.

Nga ana e tyre gjithashtu do duhej të bëhej përkrahimi për firmat të cilat nuk kanë pasur performancë adekuate, me qëllim të evitimit të operatorëve që të marrin pjesë në tenderë të ministrive të njëjta, pra duke krijuar listën e zezë të kompanive, që nuk përmbushin obligimet e veta dhe gjatë procesit të tenderit të ketë pikë negative, në mënyrë që projektet e realizuara të jenë cilësore.

Fahredin Verbovci, Departamenti i Prokurimit në Policinë e Kosovës- Theksoi se të gjitha raportet që janë bërë për Policinë e Kosovës, atë të Auditorit të Përgjithshëm dhe

të mekanizmave të tjerë që inspektojnë policinë si departament i kemi marrë në konsideratë dhe është bërë plan veprimi në mënyrë që rekomandimet e dala nga këto raporte të merren në konsideratë. Policia e Kosovës duhet të bashkëpunoj ngushtë me KRPP-në. Gjithashtu marrë parasysh natyrën e mallit me të cilin shërbehet Policia e Kosovës, i cili është më specifik, procedurat për marrjen e tij kërkon kohë, siç është marrja e lejeve të autoritetit kontraktues dhe procedurat e mëtutjeshme.

Ndërsa sa i përket flotës, edhe kjo çështje është specifike pasi për riparimin e veturave duhet ndërhyrje e ndryshme dhe me kosto të ndryshme. Në bashkëpunim me ICITAP-in jemi duke krijuar bazën të dhënave, në mënyrë që të dihet momenti i hyrjes së veturës në flotën operative deri në daljen nga flota, duke e lehtësuar kështu planifikimin buxhetor për pjesët rezervë.

Nga raporti i KRPP-së, e cila ka bërë monitorimin e disa lëndëve, nga ana jonë është bërë argumentimi dhe kemi paraqitur raport për KRPP-në.

Fahri Maxhuni, KRPP- Pas kërkesës që ka ardhur nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, drejtuar KRPP-së për monitorimin e disa lëndëve gjatë aktivitetit të prokurimit në Policinë e Kosovës dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Nga këto dhjetë lëndë që janë monitoruar, dy prej tyre nuk janë shqyrtuar pasi kanë qenë objekt i shqyrtimit në OSHP(Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik), ndërsa në tetë aktivitetet e prokurimit të cilat janë monitoruar nga ana e KRPP-së janë identifikuar të gjetura të cilat i janë paraqitur komisionit parlamentar.

Vjollca Krasniqi- Edhe pse në takim mungojnë përfaqësuesit e MPB-së që merren me çështjet e prokurimit, tutje bëri pyetje për z. Fahredin Verbovci.

A ka ndikime nga punëdhënësit tuaj në përcaktimin e ofertuesve apo favorizimin e tyre gjatë procesit të tenderimit?

Në rastet e aktiviteteve të pa planifikuara, pse bëhet shpallja e tenderëve për këto raste?

Fahredin Verbovci- Tha se gjatë këtij procesi nuk ka asnjë ndikim nga ana e nivelit më të lartë në kuadër të Policisë së Kosovës.

Ndërsa në përgjigjeje të pyetjes së dytë tha se Policia e Kosovës e ka në konsideratë aspektin e zhvillimit të politikave, siç është p.sh menaxhimi i integruar i kufijve, për të cilin nuk ka mundur të bëhet planifikimi më herët dhe kjo është arsyeja se pse veprohet në disa raste kështu.

Vjollca Krasniqi- Për njërën nga lëndët e monitoruara nga ana e KRPP-së me propozimin e komisionit, siç është mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve për kontrollimin e dokumentacionit identifikues. Gjatë monitorimit për këtë lëndë ka dal se është shkelur neni 57.3, i Ligjit për Prokurim Publik, dhe se ofertuesi në dokumentacionin e tij nuk e posedon sigurimin e ekzekutimit në vlerën prej 10%, ndërsa nga përgjigja e departamentit të prokurimit të policisë, është thënë se ky dokument është sjell më vonë.

Kur është ardhur ky dokument në dosje?

Goran Marinković- Mbikëqyrja financiare e sektorit të sigurisë nënkupton që financat publike të ndara nga ana e shtetit për sigurinë publike, duhet shpenzuar në mënyrë transparente dhe përgjegjëse.

Në lidhje me këtë kam pyetje për z. Verbovci si në vijim.

Në sektorin që e përfaqëson që është ai i prokurimit, u tha se ka pasur disa gabime dhe se këto gabime janë dorëzuar për përmirësim. Cilat janë ato gabime, a janë gabime procedurale apo financiare?

Cilat hapa janë ndërmarr për zyrtarët që kanë bërë shkelje të tilla?

Fahredin Verbovci- Për çështjet teknike të cilat kanë qenë mungesa e dokumentacionit, për këtë qëllim është bërë plani i veprimit i cili është bërë bazuar në raportin e auditorëve dhe ky plan është shpërndarë në sektorin e logistikës, financiar dhe të prokurimit në mënyrë që të grithë të jenë të përgjegjshëm për punën që bëjnë.

Fatmir Xhelili- Drejtoi pyetje për përfaqësuesit e KRPP-së dhe Policisë së Kosovës si në vijim.

Kush është përgjegjës tek prokurimi, a është drejtori i prokurimit? Komisionet që bëjnë përzgjedhjen e tenderëve, pse në përbërjen e tyre të mos ketë zyrtar të prokurimit? Kush është përgjegjës për këtë, drejtori i përgjithshëm i policisë apo Ministri?

Ndërsa pyetjet për përfaqësuesit e KRPP-së. Cili është mekanizmi për Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë apo Ministrin për të kontrolluar mirëvajtjen e një tenderi?

Pse përzgjidhen në Komision njerëz që nuk janë zyrtar të prokurimit?

Hamdi Hyseni, Drejtor për Buxhet dhe Financa, Policia e Kosovës- Theksoi se departamenti që drejton është përgjegjës për zbatimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike, rregullave financiare të thesarit dhe udhëzimeve administrative të tjera, por nuk është përgjegjës për procesin deri në momentin e lidhjes së kontratës.

Ndërsa kur të vjen lënda për pagesë nga ky departament shikohet nëse i ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas kontratës dhe pas këtij vlerësimi ekzekutohet pagesa.

Ndërsa sa i përket Komisionit që bënë vlerësimin e tenderit, me ligjin e ri përveç që Komisioni është përgjegjës për vlerësimin e një tenderi, me qëllim të ngritjes së llogaridhënies i kanë dhënë autoritet që kontrata të nënshkruhet nga udhëheqësi më i lartë i organizatës, në rastin konkret ministri, ndërsa për kontrata me vlerë të vogël përgjegjës është menaxheri i prokurimit. Ndërsa përcjelljen e kontratave e bënë Njësia kërkuese, ndërsa me lagjin e ri të prokurimit është kërkuar themelimi i një njësie, aktualisht Policia e Kosovës ka dy zyrtar për monitorimin e kontratave.

Fahri Maxhuni, KRPP- Duke iu referuar pyetjes së z. Fatmir Xhelili, se kush është përgjegjës për çështjet e prokurimit, përgjegjës është zyrtari kryesor i prokurimit, pasi sipas ligjit ai është përgjegjës për nënshkrimin, ndërsa Ministri vjen pas tij.

Ndërsa sa i përket Komisionit, duhet të kemi të qartë se ai ka rol këshillëdhënës ndërsa përgjegjës është zyrtari i prokurimit, por gjithmonë në bashkëpunim me zyrtarin kryesor administrativ, qoftë ministër apo zyrtar tjetër i lartë. Ndërsa sa i përket përcjellje së

implementimit të projekteve, sipas Ligjit për Prokurimin Publik, duhet të caktohet Komision ad-hoc dhe sipas natyrës së punës dhe jo të caktohen paraprakisht dhe të dihet se kush do të menaxhoj, pasi mund të ketë keqpërdorime.

Hamdi Hyseni- Theksova se përcjelljen e kontratës e bën menaxheri i fushës përkatëse, ndërsa caktimi i zyrtarëve në Policinë e Kosovës janë në Njësinë e cila merret me menaxhimin e kontratave, përcjellin urdhëresat, nëse kontraktori po i përmbush kushte kontraktuese në afatin e paraparë. Në rastet ku ka vërejtje atëherë kjo njësi është komunikuese mes kompanisë dhe institucionit kontraktues.

Fahredin Verbovci- Shtoi se kjo njësi është në kuadër të Departamentit të shërbimeve, dhe përkujdeset për menaxhimin e kontratës së caktuar, ndërsa për përcjelljen e kontratës, secila njësi do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e kontratës për një fushë të caktuar.

Fahri Maxhuni- Theksoi se Ligji për prokurimin publik thotë: zyrtari i prokurimit dhe zyrtari kryesor administrativ do të caktojnë një komision për mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së punës, cilësisë dhe të gjitha këto në bazë të dokumentacionit të tenderit.

Ligji për Prokurim Publik i Republikës së Kosovës është më i ngurtë në krahasim me ato të vendeve të BE-së dhe Bankës Botërore, ndërsa ligji i Kosovës është më i ngurtë në këtë drejtim, prandaj duhet të ketë më shumë përgjegjësi në specifikimin e dosjes së tenderit.

Ramiz Lladrovci- Duke iu referuar diskutimit theksoi se organizatat buxhetore ka të drejtën e blerjeve jashtë planifikimeve, por duhet të lajmëruar zyra e AKP-së, ndërsa sa i përket ndikimeve politike mund të ketë por edhe mos të ketë. Tutje theksoi rastin e kontratës për furnizim me ushqim dhe pije në vitin 2011, ku gabimet aritmetike kanë qenë më të mëdha se ato të lejuarat, dhe kjo duhet parë nga ana e KRPP-së. Prandaj vlerësoj se shkelje ka por këto duhet adresuar në vendin e duhur dhe jo të paragjyken.

Avdyli Limani, KRPP- Duke iu referuar diskutimit për komisionin e vlerësimit, theksoi se sipas ligjit për prokurim publik ky komision formohet nga zyrtarët përgjegjës i prokurimit në bashkëpunim me zyrtarin administrativ dhe përbërja të jetë profesionale. Ndërsa sa i përket zyrtarëve në Policinë e Kosovës që mbulojnë këtë fushë janë të lemive të tjera.

Fahri Maxhuni- Duke iu referuar çështjes që ngriti z. Lladrovci për cemin më të ulët, tha se ligji e mundëson një gjë të tillë por duke marrë parasysh çmimin aktual të tregut, ndërsa në rastin kur kemi tejkallim të çmimit të tregut, në këtë rast është e drejta e anulimit të procedurës së prokurimit.

Kryetari i Komisionit- Qëllimi i grupit punues për mbikëqyrjen financiare ka qenë evidentimi i elementeve të cilat përbëjnë shkelje dhe në rastet kur nga grupi punues është vlerësuar se mund të ketë shkelje, janë fokusuar në atë çështje dhe në segmente të caktuara. Ndërsa ë anën tjetër e konsideroj si dobësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme që nuk është korrekte në funksionimin institucional dhe komunikimin me

institucionet ligjvënëse dhe të ekzekutivit, ndërsa përfaqësuesit nga Policia e Kosovës dhe nga KRPP-ja i falënderojmë për kontributin e tyre.

Ramiz Lladrovci- Vlerësoi se puna që ka bërë Komisioni për Punë të Brendshme ka qenë e një natyre tjetër nga ajo e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe se kjo do të shërbej pozitivisht.

Fatmir Xhelili- Falënderoi përfaqësuesit nga KRPP-ja dhe PK-ja për kontributin e tyre dhe shtoi se Komisioni do të dal me një raport përfundimtar për mbikëqyrjen e shpenzimeve financiare nga ana e institucioneve të sigurisë, duke propozuar rekomandimet të cilat do të ndikojnë në evitimin e lëshimeve nga ana e Policisë së Kosovës dhe MPB-së. Gjithashtu pas aprovimit të këtij raporti do të përcjellim implementimin e rekomandimeve që janë propozuar.

Kryetari i Komisionit- Në mbyllje të këtij dëgjimi publik, falënderoi grupin punues i cili ka bërë mbikëqyrjen e shpenzimeve financiare në segmentet të caktuara të sektorit të sigurisë, duke dal me disa rekomandime të cilat do të ndihmojnë në përmirësimin e menaxhimit të financave publike. Gjithashtu falënderoi përfaqësuesit e PK-së dhe KRPP-së për kontributin e tyre.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi